

**DIREKTIVA NR. 96/97/KE, QË NDRYSHON DIREKTIVËN NR. 86/378/KEE  
MBI ZBATIMIN E PARIMIT TË TRAJTIMIT TË BARABARTË PËR BURRIN  
DHE GRUAN NË SKEMAT E MBROJTJES SOCIALE NË PUNË**

*(20 dhjetor 1996)*

Këshilli i Bashkimit Evropian,

Duke pasur parasysh Traktatin që krijon Bashkimin Evropian dhe në veçanti Nenin 100 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin nga Komisioni,

Duke pasur parasysh opinionin nga Parlamenti Evropian,

Duke pasur parasysh Opinionin e Komitetit Ekonomik dhe Social,

Ndërkohë që Neni 119 i Traktatit parashikon se çdo shtet anëtar duhet të sigurojë zbatimin e parimit se burrat dhe gratë duhet të marrin pagë të barabartë për punë të barabarta;

Ndërkohë që “pagë” duhet të merret në kuptimin e një page ose rroge bazë të thjeshtë ose minimale dhe çdo shpërblim tjetër, qoftë në kesh apo në ndonjë lloj tjetër, për të cilën paguhet punëtori, direkt apo indirekt, nga ana e punëdhënësit për shkak të punësimit të tij;

Ndërkohë që në gjykimin e saj të datës shtatëmbëdhjetë maj njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë, në Çështjen nr. 262/88 Barber kundër Grupit të Shkëmbimit dhe Sigurimit të Rojeve Mbretërore, Gjykata e Drejtësisë e Komunitetit Evropian pranoi se të gjitha format e pensionit të punës përbëjnë një element të pagesës në kuptimin e nenit 119 të Traktatit;

Ndërkohë që gjykimi i sipërpërmendur, siç është shpjeguar nga vendimi gjyqësor i datës katërmëdhjetë dhjetor njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tre (Çështja C-110/91: Moroni kundër Collo GmbH), Gjykata e interpreton Nenin 119 të Traktatit në një mënyrë të tillë që diskriminimi midis burrit dhe gruas në skemat e mbrojtjes sociale të punës, është në përgjithësi i ndaluar dhe jo vetëm për sa i përket përcaktimit të moshës për të pasur të drejtën për një pension apo kur një pension pune ofrohet në një formë kompensimi, për një tërheqje të detyruar në pension, mbi baza ekonomike;

Ndërkohë që në përputhje me Protokollin nr. 2, lidhur me nenin 119 të Traktatit, bashkëlidhur Traktatit që themelon Bashkimin Evropian, shpërblimet sipas skemave të mbrojtjes sociale të punës nuk do të konsiderohen si një pagesë nëse dhe për aq sa ato i takojnë periudhave të punësimit para datës shtatëmbëdhjetë maj njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë, përveç rasteve ku punëtorët ose ato që pretendojnë për ato, të cilët, para asaj

date, kanë filluar një proces ligjor apo kanë ngritur një pretendim ekuivalent sipas ligjit të zbatueshëm kombëtar;

Ndërkohë që, në gjykimin e saj të datës njëzet e tetë shtator njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e katër (Çështja C-57/93: Vroege kundër NCIV Instituut voor Volkshuisvesting BV dhe Çështja C 128/93: Fisscher kundër Voorhuis Hengelo BV), Gjykata ka vendosur se Protokolli i lartpërmendur, nuk ndikoi në të drejtën e bashkimit në një skemë pensioni pune, i cili vazhdon të rregullohet nga vendimi i datës trembëdhjetë maj njëmijë e nëntëqind e tetëdhjetë e gjashtë në Çështjen 170/84: Bilka-Kaufhaus GmbH kundër Hartz, dhe se kufizimi i efekteve në kohën të vendimit të shtatëmbëdhjetë majit njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë në Çështjen C-260/88: Barber kundër Grupit të Shkëmbimit dhe Sigurimit të Rojeve Mbretërore, nuk zbatohet për të drejtën e bashkimit në një skemë pensioni pune;

Ndërkohë që gjykata ka vendosur se rregullat kombëtare që kanë lidhje me afatet kohore për ndërmarrjen e veprimeve sipas ligjit kombëtar mund të referohen kundër punëtorëve që kërkojnë të drejtat e tyre për tu bashkuar në një skemë pensioni pune, me kusht që ata të mos trajtohen në mënyrë më pak të favorshme për atë lloj veprimi sesa për veprimet e ngjashme të një natyre të brendshme dhe që ata të mos të bëjnë të pamundur ushtrimin në praktikë, të drejtave të përcaktuara nga ligji Komunitar;

Ndërkohë që Gjykata ka theksuar gjithashtu se fakti që një punëtorë mund të pretendojë, në mënyrë retroaktive, për tu bashkuar në një skemë pensioni pune, nuk e lejon punëtorin t'i shmanget pagimit të kontributeve të lidhura me periudhën e anëtarësisë në fjalë;

Ndërkohë që përjashtimi i punëtorëve mbi bazën e natyrës së kontratave të tyre të punës për hyrjen në një kompani apo skeme mbrojtjeje sociale sektoriale mund të përbëjë diskriminim indirekt kundër grave;

Ndërkohë që, në vendimin e datës nëntë nëntor njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tre (Çështja C-132/92: Birds Eye Walls Ltd kundër Friedel M. Roberts),

Gjykata ka specifikuar gjithashtu se nuk është në kundërshtim me nenin 119 të Traktatit, ku llogaritet shuma e pensionit të parakohshëm e cila i është paguar një punëtori mashkull dhe femre, nga një punëdhënës, të cilët kanë dalë në pension më shpejtë për shkak të sëmundjeve shëndetësore dhe për të cilat pritet që të kompensohen, në veçanti, për humbjen e të ardhurave që rezultojnë nga fakti që ata nuk e kanë mbushur ende moshën e kërkuar për dhënien e pensionit shtetëror, të cilën do ta marrin më pas dhe për reduktimin e shumës së pensionit të parakohshëm, në përputhje, edhe pse, në rastet e burrit dhe gruas të moshës gjashtëdhjetë dhe gjashtëdhjetë e pesë vjeç, rezultati është se një ish punëtoreshë merr një pension më të vogël të parakohshëm sesa ajo që i paguhet kolegut të saj mashkull, diferenca është e barabartë me shumën e pensionit shtetëror të cilën ajo e fiton që nga moshën gjashtëdhjetë vjeç në lidhje me periudhat e shërbimit të përbushur me atë punëdhënës;

Ndërkohë që në vendimet e tij të gjashtë tetorit njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tre (Çështja C- 109/91: Ten Oever v. Stichting Bedrijfspensioenfonds voor het Glazenwassers- en Schoonmaakbedrijf) dhe në vendimet e tij të katërbëdhjetë dhjetorit njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tre (Çështja C-110/91: Moroni kundër Collo GmbH), të njëzet e dy dhjetorit njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tre (Çështja C-152/91: Neath kundër Hugh Steeper Ltd) dhe njëzet e tetë shtatorit njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e katër (Çështja C-200/91: Coloroll Pension Trustees Limited kundër Russell dhe të Tjerëve), Gjykata konfirmon se, duke u mbështetur në vendimin e shtatëmbëdhjetë majit njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë (Çështja C-262/88: Barber kundër Guardian Royal Exchange Assurance Group), mund të zbatohet efekti i drejtpërdrejtë i nenit 119 të Traktatit, me qëllim kërkimin e trajtimit të barabartë në çështjet e pensionit të vjetërsisë në punë, vetëm në lidhje me fitimet të cilat janë të pagueshme për periudhat e shërbimit pas shtatëmbëdhjetë majit njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë, përjashtuar këtu rastin e punëtorëve ose të atyre që veprojnë në emër të tyre që kanë nisur, përpara kësaj date, procedurat ligjore ose kanë ngritur të njëjtën padi në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm kombëtar.

Ndërkohë që, edhe në vendimet e sipërpërmendura (Çështja C-109/91: Ten Oever v. Stichting Bedrijfspensioenfonds voor het Glazenwassers- en Schoonmaakbedrijf dhe Çështja C-200/91: Coloroll Pension Trustees Limited kundër Russell dhe të tjerëve), Gjykata konfirmon se kufizimi i efekteve në kohë të vendimit për çështjen Barber u zbatohet pensioneve të mbijetuarve, dhe rrjedhimisht, trajtimi i barabartë në këtë çështje mund të kërkohet vetëm në lidhje me periudhat e shërbimit pas datës shtatëmbëdhjetë maj njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë, përveçse në rastin e atyre që kanë nisur, përpara kësaj date, procedurat ligjore ose kanë ngritur të njëjtën padi në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm kombëtar.

Ndërkohë që, për më tepër, në vendimet e tij në Çështjen C-152/91 dhe Çështjen C-200/91, Gjykata specifikon që kontributet e punëtorëve meshkuj dhe femra në një skemë të caktuar përfitimi pensioni duhet të jenë të njëjta, përderisa janë të mbuluara nga neni 119 i Traktatit, ndërsa pabarazia e kontributeve të paguara nga punëdhënësit sipas skemave të caktuara përfituese, të cilat vijnë si pasojë e përdorimit të faktorëve të sigurimeve që ndryshojnë në bazë gjinie, nuk duhet të shikohet nga pikëpamja e të njëjtës dispozitë.

Ndërkohë që, në vendimet e tij të njëzet e tetë shtatorit njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e katër (Çështja C-408/92: Smith kundër Advel Systems dhe Çështja C-28/93: Van den Akker kundër Stichting Shell Pensionenfonds), Gjykata theksoi se neni 119 i Traktatit e pengon një punëdhënës, i cili merr masa të nevojshme për të qenë në përputhje me vendimin Barber të shtatëmbëdhjetë majit njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë (C-262/88), të rrisë moshën e pensionit për gratë në të njëjtin nivel me burrat në lidhje me periudhat e shërbimit të realizuara ndërmjet shtatëmbëdhjetë majit njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë dhe datës në të cilën këto masa kanë hyrë në fuqi; nga ana tjetër, përsa i përket periudhave të shërbimit të realizuara pas datës së fundit, neni 119 nuk pengon asnjë punëdhënës të marrë një hap të tillë; përsa i përket periudhave të shërbimit përpara datës shtatëmbëdhjetë maj njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë, ligji Komunitar nuk ushtron

ndonjë detyrim që mund të justifikonte pakësimin prapaveprues të avantazheve që gëzonin gratë.

Ndërkohë që, në vendimin e lartpërmendur në Çështjen C-200/91: Coloroll Pension Trustees Limited kundër Russell dhe të tjerëve), Gjykata vendosi që përfitimet shitesë, që rrjedhin nga kontributet e paguara nga punëmarrësit mbi baza krejtësisht vullnetare, nuk mbulohen nga neni 119 i Traktatit.

Ndërkohë që, ndërmjet masave të përfshira në programin e trete afat-mesëm të veprimit, mbi mundësitë e barabarta për burrat dhe gratë (njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e një deri në njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e pesë), Komisioni thekson edhe një herë miratimin e masave të përshtatshme për të marrë parasysh rrjedhojat e vendimit të datës shtatëmbëdhjetë maj njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë në Çështjen 262/88 (Barber kundër Guardian Royal Exchange Assurance Group);

Ndërkohë që, vendimi zhvlerëson automatikisht disa dispozita të Direktivës së Këshillit 86/378/KEE, të njëzet e katër korrikut njëmijë e nëntëqind e tetëdhjetë e gjashtë, mbi zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë për burrat dhe gratë në skemat e sigurimit shoqëror në punë në lidhje me punëtorët me pagesë;

Ndërkohë që, neni 119 i Traktatit zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe mund të përdoret përpara gjykatave kombëtare kundër çdo punëdhënësi, qoftë ky një person fizik apo juridik, u takon këtyre gjykatave të mbrojnë të drejtat të cilat kjo dispozitë ia akordon individëve;

Ndërkohë që, për arsye të qartësisht ligjor, është e nevojshme të ndryshohet Direktiva 86/378/KEE (Komiteti Ekonomik Europian), me qëllim miratimin e direktivave të ndikuara nga precedenti ligjor Barber.

Ka miratuar këtë Direktivë:

### **Neni 1**

Direktiva 86/378/KEE, do të ndryshohet si vijon:

1. Neni 2 do të zëvendësohet si më poshtë:

### **Neni 2**

1. “Skemat e sigurimit shoqëror në punë”, nënkuptojnë skemat të cilat nuk rregullohen nga Direktiva 79/7/EEC dhe që kanë për qëllim t'u mundësojnë punëtorëve, të vetë-punësuar ose jo, në një sipërmarrje ose një grup sipërmarrjesh, zonë aktiviteti ekonomik, sektori punësues ose grupi sektorësh me përfitime, me qëllim plotësimin ose zëvendësimin e përfitimeve të mundësuar nga skemat e sigurimit shoqëror të përcaktuara me ligj, pavarësisht anëtarësisht të detyrueshëm apo vullnetar në këto skema.

2. Kjo direktivë nuk zbatohet në rastin e:

- a. kontratave individuale për punëtorët e vetë punësuar;
- b. skemave për punëtorët e vetë punësuar që kanë vetëm një anëtar;
- c. kontratave të sigurimit në të cilat punëdhënësi nuk është palë, në rastin e punëtorëve me pagesë;
- d. dispozita jo detyruese të skemave të punësimit ofruar pjesëmarrësve në mënyrë individuale me qëllim garantimin:
  - e përfitimeve shtesë, ose
  - përcaktimin e një date në të cilën do të fillojnë përfitimet normale të punëtorëve të vetë punësuar, ose mundësinë e zgjedhjes midis disa përfitimeve;
- e. skema punësimi në të cilat përfitimet financohen nga kontributet e punëtorëve mbi baza vullnetare.

3. Kjo Direktivë nuk e pengon një punëdhënës që tu ofrojë personave të cilët kanë arritur moshën e pensionit për qëllim ofrimin e një pensioni sipas një skeme punësimi, por që nuk kanë arritur ende moshën e pensionit për qëllim të ofrimin të një pensioni suplementar, qëllimi i së cilës është të barazojë shumën totale të përfitimeve të paguara për këta persona dhe shumës së paguar për personat e gjinisë të kundërt në po të njëjtën situatë, që kanë arritur tashmë moshën e pensionit sipas ligjit, derisa personat që përfitojnë nga shtesa të kenë arritur moshën e pensionit sipas ligjit.

2. Neni 3 do të zëvendësohet si vijon:

#### Neni 3

Kjo Direktivë do të zbatohet për popullsinë aktive për punë, përfshirë personat e vetë-punësuar, atyre personave aktiviteti i të cilëve është ndërprerë për arsye sëmundjeje, leje lindjeje, aksidenti apo papunësie të padëshirueshme, si dhe personave të cilët janë në kërkim të punës, punëtorëve të dalë në pension dhe atyre të pa-aftë për punë, dhe ndaj atyre që veprojnë në emër të tyre, në përputhje me legjislacionin dhe/ose praktikën kombëtare.

3. Neni 6 do të zëvendësohet si vijon:

#### Neni 6

1. Dispozitat në kundërshtim me parimin e trajtimit të barabartë do të përfshijnë ato mbi bazë gjinie, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo, veçanërisht duke iu referuar gjendjes martesore apo familjare, me qëllim:

- a. përcaktimin e personave të cilët mund të jenë pjesë e një skeme punësimi;

b. përcaktimin e pjesëmarrjes, me natyrë qoftë të detyrueshme ose vullnetare, në një skemë punësimi;

c. hartimin e rregullave të ndryshme mbi moshën e hyrjes në këtë skemë ose të periudhës minimale kohore të punësimit ose anëtarësimit në këtë skemë me qëllim përfitimin prej saj;

d. hartimin e rregullave të ndryshme, përveç atyre të parashikuara në pikat h. dhe i., për rimbursimin e kontributeve kur një punëtor largohet nga një skemë pa përmbushur kushtet duke mos garantuar kështu të drejtat për përfitime afatgjata;

e. vendosjen e kushteve të ndryshme për sigurimin ose kufizimin e këtyre përfitimeve të punëtorëve të njërit apo tjetrës gjini;

f. fiksimin e moshave të ndryshme të pensionit;

g. pezullimin e mbajtjes apo përfitimit të drejtave gjatë periudhave të lejes së lindjes ose lejes për arsye familjare, të garantuara nga ligji ose marrëveshja dhe të paguara nga punëdhënësi;

h. përcaktimin e niveleve të ndryshme të përfitimit, përveçse në raste kur është e nevojshme të merren parasysh faktorët përlllogaritës të sigurimeve të cilët ndryshojnë në bazë gjinie në rastet e skemave të caktuara të kontributit;

Në rastin e skemave të caktuara të përfitimeve, elementë të caktuar (rastet e të cilave janë bashkëlidhur) mund të jenë të pabarabarta kur pabarazia e shumave që rezultojnë nga efektet e përdorimit të faktorëve të sigurimeve ndryshojnë mbi bazën e gjinisë, në kohën kur është realizuar financimi i skemës;

i. përcaktimin e niveleve të ndryshme për kontributet e punëtorëve;

j. përcaktimin e niveleve të ndryshme për kontributet e punëdhënësve, përveçse:

- në rastin e skemave të caktuara të përfitimeve, nëse qëllimi është barazimi i shumës së përfitimeve përfundimtare ose bërja e tyre pothuajse të barabarta për të dyja gjinitë,

- në rastin e skemave të caktuara të përfitimeve, kur kontributet e punëdhënësve synojnë sigurinë e mjaftueshmërisë së fondeve të nevojshme për mbulimin e kostos së caktuar të përfitimeve,

k. vendosjen e standardeve të ndryshme ose standardeve që zbatohen vetëm për punëtorët e një gjinie të caktuar, përveç rasteve të parashikuara në pikat h dhe i, lidhur me garantimin ose mbajtjen e të drejtës për përfitime të mëvonshme kur një punëtor largohet nga skema.

3. Kur ofrimi i përfitimeve, në përputhje me qëllimin e kësaj Direktive, lihet në kompetencë të strukturave drejtuese të skemës, këta të fundit duhet të veprojnë në përputhje me parimin e trajtimit të barabartë.

4. Neni 8 do të zëvendësohet si vijon:

#### Neni 8

1. Shtetet anëtare do të marrin hapat e nevojshme për të siguruar që dispozitat e skemave të punësimit për punëtorët e vetë-punësuar në kundërshtim me parimin e trajtimit të barabartë, të rishikohen duke i shtrirë efektet që nga një janari njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tre, si afati më i fundit.

2. Kjo Direktivë nuk do të cenojë të drejtat dhe detyrimet që lidhen me një periudhë anëtarësimi në një skemë punësimi për punëtorët e vetëpunësuar përpara rishikimit të kësaj skeme, që i nënshtrohen dispozitave të skemës që janë në fuqi gjatë kësaj periudhe.

5. Neni 9 do të zëvendësohet si vijon:

#### Neni 9

Përsa i përket skemave për punëtorët e vetë-punësuar, shtetet anëtare mund të shtyjnë afatin e zbatimit të detyrueshëm të parimit të trajtimit të barabartë në lidhje me:

a. përcaktimin e moshës së pensionit për dhënien e pensioneve të pleqërisë dhe pasojave të mundshme për përfitime të tjera:

- ose deri në datën kur kjo barazi është arritur në skemat e përcaktuara me ligj,
- ose, tek e fundit, derisa kjo barazi të parashikohet nga një direktivë;

b. pensionet e të mbijetuarve derisa ligji Komunitar të vendosë parimin e trajtimit të barabartë në skemat e sigurimit shoqëror të përcaktuara me ligj;

c. zbatimin e nën paragrafit të parë të pikës i të nenit 6 (1), duke marrë parasysh faktorët e ndryshëm përlllogaritës të sigurimeve, maksimalisht deri në një janar njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë.

6. Do të shtohet neni i mëposhtëm:

#### Neni 9a

Nuk do të konsiderohet si jo në përputhje me këtë Direktivë, rasti kur burrat dhe gratë mund të kërkojnë një moshë fleksibile pensioni brenda të njëjtave kushteve.

7. Do të shtohet Shtojca e mëposhtme:

#### Shtojcë

Shembuj të elementëve të cilët mund të jenë të pabarabartë, sipas skemave të përcaktuara të përfitimeve, sikurse janë referuar në nenin 6 (h):

- shndërrimi në një shumë kapitale të një pjese të një pensioni periodik,
- transferimi i të drejtave të pensionit,
- një kompensim pensioni që i paguhet një personi në ngarkim, në këmbim të heqjes dore nga pjesa e një pensioni,
- një pension i reduktuar kur punëtori vendos të marrë pension të parakohshëm.

## **Neni 2**

1. Çdo masë zbatuese e kësaj Direktive, përsa i përket punëtorëve me pagesë, duhet të përfshijë të gjitha përfitimet që rrjedhin nga periudhat e punësimit pas shtatëmbëdhjetë majit njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë dhe do të zbatohet, në mënyrë prapavepruese, që nga ajo ditë pa cenuar punëtorët ose ato që veprojnë në emër të tyre, të cilët kanë nisur përpara kësaj date procedurat ligjore ose kanë ngritur një padi të njëjtë sipas ligjit kombëtar. Në këtë rast, masat zbatuese duhet të zbatohen, në mënyrë prapavepruese, që nga data tetë prill njëmijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e gjashtë dhe duhet të përfshijnë të gjitha përfitimet e rrjedhura nga periudha e punësimit pas kësaj date. Për shtetet anëtare të cilat u anëtarësuan në Komunitet pas datës tetë prill njëmijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e gjashtë, kjo datë do të zëvendësohet me datën në të cilën neni 119 i këtij Traktati do të zbatohet në territorin e tyre.

2. Fjalja e dytë e paragrafit 1 nuk do të pengojë rregullat kombëtare, në lidhje me kufizimet kohore për të ndërmarrë veprime në përputhje me legjislacionin kombëtar, për të referuar kundër punëtorëve apo atyre personave që veprojnë në emër të tyre që kanë nisur procedurat ligjore ose kanë ngritur një padi të njëjtë sipas ligjit kombëtar, përpara datës shtatëmbëdhjetë maj njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë, me kusht që këto rregulla të mos jenë më pak të favorshme për këtë lloj veprimi sesa për veprime të ngjashme të një natyre të brendshme, dhe që këto rregulla të mos e bëjnë të pamundur në praktikë zbatimin e ligjit Komunitar.

3. Për shtetet anëtare, anëtarësimi i të cilave u krye pas datës shtatëmbëdhjetë maj njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë dhe të cilat kanë qenë, që nga një janari njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e katër, palë kontraktuese të Marrëveshjes mbi Zonën Ekonomike Evropiane, data shtatëmbëdhjetë maj njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë të paragrafit 1 dhe 2 të kësaj Direktive, zëvendësohet nga një janari njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e katër.

## **Neni 3**

1. Shtetet anëtare do të miratojnë ligje, rregullore dhe dispozita administrative, të nevojshme për të qenë në përputhje me këtë Direktivë, deri në një korrik njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë, për të cilën Komisioni duhet të njoftohet menjëherë.

Kur shtetet anëtare të miratojnë këto dispozita, ato duhet të përmbajnë një referencë ndaj kësaj Direktive ose të shoqërohet nga një referencë e tillë në rast të publikimit zyrtar të tyre. Metodatat e bërjes së kësaj reference do të përcaktohen nga shtetet anëtare.

2. Shtetet anëtare do të informojnë Komisionin, jo më shumë se dy vjet pas hyrjes në fuqi të kësaj Direktive, të gjithë informacionin e nevojshëm për të bërë të mundur hartimin e raportit nga Komisioni mbi zbatimin e kësaj Direktive.

#### **Neni 4**

Kjo Direktive do të hyjë në fuqi njëzet ditë pas publikimit të saj në Gazetën Zyrtare të Komunitetit Evropian.

#### **Neni 5**

Kjo Direktivë i adresohet shteteve anëtare.